



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 264, datë 28.12.2020**

**“MBI**

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 140, DATË 21.08.2020 “MBI  
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 86, DATË 12.05.2020, “MBI  
REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SOLARIS POWER” SH.P.K. PËR LICENCIM  
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 3, nenit 104 dhe nenit 113, të Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë; nenit 8 dhe nenit 10, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.142/6 prot., datë 24.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 140, datë 21.08.2020 “Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ere-s nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 12.05.2020, vendosi të refuzojë kërkesën e Shoqërisë Solaris Power sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 140, datë 21.08.2020, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e Vendimit nr. 86/2020, dhe të licencojë shoqërinë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me kushtet përkatëse, duke ndaluar dhe fillimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE iu drejtua shoqërisë me email (në postën elektronike të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë) dhe me shkresën nr. 1191, datë 11.11.2020, duke i kërkuar informacionin përkatës në lidhje me ecurinë e plotësimit nga ana e saj të kushteve si më sipër. Përveçse me postë fizike, kjo shkresë iu dërgua shoqërisë në datën 11.11.2020 dhe në postën elektronike të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë. Nuk rezulton që e-maili apo shkresa të jenë kthyer mbrapsht.

- Shoqëria “Solaris Power” sh.p.k nuk ka kthyer përgjigje për sa kërkuar nga ERE. Po ashtu nuk rezulton që shkresa apo e-maili të jenë kthyer mbrapsht.
- Shoqëria nuk ka dokumentuar në ERE asnjë përpjekje për plotësimin në afat të kushteve të Vendimit nr. 140/2020.
- Në nenin 113, të KPA-së është parashikuar se organi që nxjerr aktin administrativ, ka dhe tagrin ta anulojë, shfuqizojë apo ndryshojë atë akt, duke nxjerrë një akt të ri me shkrim, sipas formës ligjore të përcaktuar, ndaj ERE ka tagrin dhe kompetencën për të rishikuar kryesisht një akt të nxjerrë nga vetë ajo.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të shfuqizojë Vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 21.08.2020, “*Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Solaris Power” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**